



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 4. 5 të Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3.1 Rregullës Zgjedhore nr.15/2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parkohshme, si dhe bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 21 tetor 2020, Nr.157/2020, për shpalljen e zgjedhjeve jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 21 tetor 2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

## Vendim

### **Për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut.**

- I. Miratohet vendimi për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, që do të mbahen më 29 nëntor 2020.
- II. Afatet kohore për zbatimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore që ndërlidhen me zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, i referohen afatit prej 39 (tridhjetetë e nëntë) ditë si në vijim:
  - a) Afati për krijimin e Listës së Votuesve, periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit fillon më 11 nëntor dhe përfundon më 14 nëntor 2020;
  - b) Periudha e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve fillon më 21 tetor dhe përfundon më 30 tetor 2020;
  - c) Afati për vendimmarrjen e KQZ-së për certifikimin e subjekteve politike fillon më 2 nëntor 2020 dhe përfundon më 4 nëntor 2020;
  - d) Periudha për paraqitjen e përmirësimeve/korrigjimeve nga subjektet politike fillon më 22 tetor dhe përfundon më 1 nëntor 2020;
  - e) Afati për tërheqje të Subjekteve Politike fillon më 4 nëntor 2020 dhe përfundon më 10 nëntor 2020;
  - f) Data e mbajtjes së shortit për renditjen në fletëvotim dhe publikimi i subjekteve dhe kandidatëve është 12 nëntor 2020;

- g) Afati për caktimin e kufizimeve të shpenzimeve për fushatë fillon më 21 tetor dhe mbaron më 24 tetor 2020;
- h) Fushata zgjedhore si dhe afatet për tubimet zgjedhore fillojnë më 12 nëntor dhe përfundon më 27 nëntor 2020;
- i) Dorëzimi i kërkesës për akreditimin e vëzhgueseve të subjekteve politike dhe organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve fillon më 27 tetor dhe përfundon më 21 nëntor 2020;
- j) Dorëzimi i kërkesës për akreditimin e vëzhgueseve ndërkombëtar dhe mediave për vëzhgimin e zgjedhjeve fillon më 27 tetor dhe përfundon më 23 nëntor 2020;
- k) Emërimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve fillon më 26 tetor dhe përfundon më 27 tetor 2020;
- l) Publikimi i qendrave të votimit bëhet jo më vonë se 5 nëntor 2020;
- m) Aplikimi për regjistrim si votues jashtë Kosovës fillon më 30 tetor dhe përfundon më 7 nëntor 2020;
- n) Aplikimi për regjistrim për votuesit e ngjuar në shtëpi fillon 2 nëntor dhe përfundon më 6 nëntor 2020;
- o) Afati për regjistrimin për votuesit me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion dhe votuesve me rrethana të veçanta fillon më 16 nëntor dhe përfundon më 19 nëntor 2020;

III. Caktimi i afateve sipas nenit I të këtij vendimi, do të vlejë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut, që do të mbahen më 29 nëntor 2020.

IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nëshkrimit.

Prishtinë, 21 tetor 2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

